



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura VIII  
*Sesioni pranveror*

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**

P-nr.90/2024  
Prishtinë, më 28.5.2024, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Arjeta Fejza, Albana Bytyçi, Nasuf Bejta, Drita Millaku, Fatmire Kollçaku, Labinotë Demi- Murtezi, Eliza Hoxha dhe Marigona Geci.

Mungoi: Ariana Musliu- Shoshi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinatori i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e lartë në Komision.

Pjesëmarrës të tjerë: Kaltrina Ibërdemaj, GP LVV; Besarta Pllana, Kuvendi i Kosovës, Marigona Pajaziti, Kuvendi i Kosovës; Gent Ramosaj, GP AAK; dhe Celal Ilyas, Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi Duda Balje, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratim i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 30 prill 2024, 7 dhe 14 maj 2024;
3. Shqyrtimi i peticioneve;
4. Të ndryshme.

\*\*\*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetarja** konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratim i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 30 prill 2024, 7 dhe 14 maj 2024**

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më datë 30 prill, 7 dhe 14 maj 2024.

### 3. Shqyrtimi i peticioneve

**Kryetarja** ngriti çështjen e peticionit të Sindikatës së Policisë së Kosovës, për të cilin tha se i janë drejtuar disa herë ministrit të Punëve të Brendshme, për të ardhur në komision dhe të na njoftojë se a janë ndërmarrë hapa, lidhur me realizimin e kërkesave të peticionit, por nuk kemi marrë përgjigje, ende nuk kemi vendosur për këtë peticion.

**Fatmire Kollçaku**, tha se si komision iu kemi drejtuar ministrisë. E rëndësishme është që lënda është adresuar. Çka është varur nga Komisioni, është në rregull.

Ajo kërkoi nga kryetarja që peticionet që janë individuale, qoftë edhe për njoftim, mos të paraqiten në komision dhe mos të trajtohen fare, por administrata e Komisionit të përgjigjet në ato raste, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

**Kryetarja** njoftoi se kemi peticionin nga përfaqësues të Komitetit për Komunitete në Komunën Gjakovës dhe nga Komuna e Klinës, si dhe shtatë anëtarë të tjerë të Komitetit për Komunitete nga këto dy komuna. Kërkesa e tyre ka të bëjë me mundësin e gjetjes së një zgjidhje për pagesën e anëtarëve të Komitetit të Komuniteteve, të anëtarëve të jashtëm / jo asamblistë të komunave Gjakovë dhe Klinë.

Sipas kërkesës së nënshkruesve të peticionit, me ligjin në fuqi të pagave, deri më tani asnjë nga anëtarët e komuniteteve jo-shumicë nuk janë paguar për punën e realizuar.

Komitetet për komunitete, në këto dy komuna, janë formuar me vendim të kuvendeve komunale të komunave përkatëse.

Ajo njoftoi Komisionin se është interesuar për këtë çështje dhe ka marrë informata se në disa komuna, si Prizren, Prishtinë e disa komuna të tjera, i paguajnë këta anëtarë ashtu siç kanë vepruar, para hyrjes në fuqi të ligjit të ri të pagave.

**Fatmire Kollçaku**, pyeti: si është përbërja e këtyre komisioneve, a përbëhet vetëm me anëtarë të kuvendit komunal, apo me pjesëtarë tjerë, të shoqërisë civile?

**Kryetarja**, tha se këto komitete kanë përbërje edhe nga anëtarë të tjerë jo asamblistë, që nuk kanë asnjë kompensim. Lidhur me këtë peticion, është mirë që, si komision, t'i drejtohem Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që të sqarojë se a e kanë trajtuar këtë kërkesë dhe se si vepron në komunat tjera, a është gjetja e zgjidhjes në kompetencë të ministrisë apo të vetë komunave.

**Eliza Hoxha**, tha se është mirë të merret shembulli nga ato komuna që janë duke bërë pagesën e këtyre anëtarëve të komiteteve dhe të bëhet një zgjidhje e njëjtë edhe për këta.

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni, lidhur me peticionin në fjalë, të kërkojë sqarime nga Ministria e Pushtetit Lokal, se a është trajtuar kjo kërkesë nga MAPL.

**Kryetarja**, tha se kemi një kërkesë nga qytetari, Arsim Isufi, i cili ka kërkuar takim me kryetaren e Komisionit, lidhur me padrejtësitë e pretenduara nga ai, që kanë të bëjnë me largimin e tij nga puna, nga Policia e Kosovës.

Kjo është kërkesë individuale, por sa për informacion të Komisionit, tha se këtë person e ka pritur në takim dhe i ka dëgjuar problemet, të cilat ka thënë se i ka.

#### **4. Të ndryshme**

**Arjeta Fejza**, propozoi që të ftohet në takim Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës, dhe të diskutohet lidhur me rrjedhën e këtij procesi.

**Kryetarja** konstatoi se përfaqësuesit këtij Komisioni Qeveritar, të ftohen në takim të hënën, më datë 3 qershor 2024, në orën 10:00.

Anëtarët e Komisioni diskutuan edhe për shëndetin mendor në Kosovë dhe propozuan që të mbajnë një tryezë për këtë temë.

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni, së bashku me Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Grupin e Grave Deputete, do të organizojnë tryezë të përbashkët, më datë 18 qershor 2024. Ndër të tjerë, në këtë tryezë do të ftohen përfaqësues të Departamentit të Shëndetit Mendor të Ministrisë së Shëndetësisë, OJQ “Linja e Jetës”, ndërsa për institucionet dhe OJQ-të e tjera, që mund të ftohen, do të vendosin, si Komision, deri më dt. 3 qershor 2024.

Anëtarët e Komisionit diskutuan edhe për raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit të vitit 2022, i cili nuk është miratuar në Kuvend.

**Arjeta Fejza**, tha se deri në takimin e datës 3 qershor, do ta lexojnë raportin e IAP-it për vitin 2023 dhe do të bëjnë pyetje konkrete, dhe në emër të Komisionit, t’i përcillen Avokatit të Popullit për material shtesë, lidhur me raportin.

Anëtarët e Komisionit diskutuan edhe për shënimin e datës së 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve. Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni, me vota unanime të anëtarëve të pranishëm të Komisionit, nxori këtë:

#### **V e n d i m**

Komisioni Funkcional të organizojë më dt. 31 maj 2024, në orën 12:00, një drekë pune me Shoqatën “HANDIKOS”, përkatësisht, grupin e fëmijëve me nevoja të veçanta “Hëna”, i cili funksionon në kuadër të kësaj shoqate.

Dreka e punës të organizohet në njërin nga restorantet në Prishtinë.

**Kryetarja**, po ashtu konstatoi se më datën 31 maj 2024, në vigjilje të shënimit të 1 Qershorit-Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, anëtarët e Komisionit do të vizitojnë fëmijët e SOS Fshatit në Prishtinë, në orën 14:30.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Duda BALJE,  
Kryetare e Komisionit